

VETERANI

GAZETË PERIODIKE NR.03(381) MARS 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

KUJTESË



31 vjet nga greva e minatorëve të Trepçës

Bashkim Hisari

FAQE 6

PRISHTINË



PËRKUJTOHET 100 VJETORI I LINDJËS SË XHAVID NIMANIT

Drita Rexhepi

FAQE 7

RRËFIMI I PETRO MARKOS



RIZA TAHIR TITINI, DËSHMORI QË VDIQ NË KAMPIN E MAT'HAUZENIT

Sakip Cami & Shuaip Met'hasani

FAQE 4

Kolonel Ing. MYFIT GUXHOLLI – Kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar

Kontributi i Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore

Koha për kompromis historik

Halil RAMA*
Muharrem GJOKA*

Katër vjet më parë, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku, në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) u drejtoi një promemorie krerëve më të lartë të shtetit (ish-Presidentit të RSH, Bujar Nishani, ish-kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta dhe kryeministrit Edi Rama, si dhe kryetarëve të partive parlamentare, ku argumentonte domosdoshmërinë e unifikimit të qëndrimeve në funksion të integritimit euroatlantik të vendit. Apeli i generalit legjendë bëhej në një kohë kur klima politike në vend ishte tejte e tensionuar

“Në moshën time të thyer, 97 vjeçare, përballë revanshit të nostalgjikëve të diktaturës komuniste dhe ekstremistëve pa fre të të dyja palëve, e ndjej si obligim t’ju bëj thirrje, që t’i riktheheni arsyes së shëndoshë, për të realizuar PAJTIMIN KOMBËTAR, aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e të gjitha kohërave”, shkruante general Parllaku në promemorien e tij para katët vitesh.

Kryesia e OBVL konkludon se kjo promemorie është në koherencë të plotë me aktualitetin e sotëm, kur klasa politike, si në Shqipëri edhe në Kosovë është në qëndrime ekstreme dhe tejte konfliktuale. Ajo e konsideron të palejueshme këtë situatë, kur para këtyre sulmeve e insinuatave të ndërsjella, krerët e shtetit dhe të institucioneve duhet të merren me hallet e popullit, punësimin, rimëkëmbjen e ekonomisë, luftën kundër krimit, drogës e korrupsionit. Me këto qëndrime politika shqiptare dhe ajo kosovare jep shembullin më të keq edhe për bashkëkombasit tanë në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi. Ndasia vetëm dëm i sjell kombit dhe çështjes sonë kombëtare.

Për këtë arsye, OBVL ju bën thirrje të heqin dorë nga kjo gueti shtrigash ndaj


Vijon në faqen 8



- *Ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ne krenohemi me 70 mijë partizanët që bënë atë luftë vendimtare për çlirimin e vendit. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane*
- *Kur na ndajnë vetëm pak kohë nga 75-vjetori i përfundimit të luftës më të përgjakshme që kishte parë njerëzimi ndonjëherë, kacafytja kundër nazifashizmit, shqiptarët kanë të drejtë të krenohen me kontributin e tyre gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.*

FAQE 2 = 3

NDERIMI



Ish oficeri shembullor i marinës Selman Rama do të kujtohet gjithnjë me nderim të veçantë

Nga Zaim SEFA

FAQE 5

RRUGËTIMI

TAFIL BOLETINI NË MBROJTJE TË HEBREJVE

Nga Moza Boletini

FAQE 5

HOMAZH

KOLONEL QAZIM BAJRAM DAUTAJ, MODELI MË I MIRË I USHTARAKUT TË USHTRISË SHQIPTARE

Ali Demushi

FAQE 9

7 MARS

35 VITET E MËSUESIT FISNIK ADEM KADRI LAÇI

Xhemal Meçi

FAQE 10

DITËLINDJA

SHPENDI TOPOLLAJ FESTON DITËLINDJEN E 73-TË ME LIBRA TË RINJ

KADRI TARELLI

FAQE 12

LETRAT

VIZION GRUAJE

Cikël me poezi, nga Liljana Muça

FAQE 11

IN MEMORIAM

MARK LLESHI – VETË I SHTATË, BASHKË ME TRIMAT LAJTHIZAKË

ZEF RROZHANI

FAQE 8

HOMAZH

TAHIR ADEM HAJREDINAJ, INTELEKTUALI QË E NDERON GJITHË TROPOJA

Isuf IMERAJ

FAQE 8

HISTORIA

Kolonel Ing. MYFIT GUXHOLLI – Kryetar i Organizatës së Kontributi i Shqipërisë në Luftën



• Ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ne krenohemi me 70 mijë partizanët që bënë atë luftë vendimtare për çlirimin e vendit. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane



Në historinë e Shqipërisë, pjesëmarrja në Luftën e Dytë Botërore përbën një ndër ngjarjet historike më të rëndësishme kombëtare. Shqipëria u rreshtua në krah të Kombeve të Bashkuara Antifashiste dhe u trajtua si një aleat i cili luftoi në Koalicionin e fitimtarëve të Luftës për kontributin real që dha në këtë Luftë kombi shqiptar. Historianë vendas dhe të huaj, në vlerësimin që i kanë bërë historisë së Shqipërisë për këtë periudhë kohore dhe kontributit të vendit tonë, janë shprehur se kontributi i Shqipërisë është domethënës jo nga numri i popullsisë dhe i forcave që u angazhuan në luftë, por i mesazhit, i rreshtimit të drejtë që bëri, në një moment të rëndësishëm historik. Gjithashtu, shqiptarët, në respekt të traditës së besës së dhënë, kanë meritë dhe kontribut të veçantë si kombi që mbrojti hebrenjë dhe nuk ua dorëzoi ata pushtuesve nazistë, duke hyrë në historinë e Luftës së Dytë Botërore si "komb i nderit. Në Luftën e Dytë Botërore u derdh gjaku edhe i qindra shqiptarëve ku u tregua me fakte ndihmesa shqiptare për çlirimin e popujve të Ballkanit, si dhe kontributi real i kombit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore.

Kur na ndajnë vetëm pak kohë nga 75-vjetori i përfundimit të luftës më të përgjakshme që kishte parë njerëzimi ndonjëherë, kacafytja kundër nazifashizmit, shqiptarët kanë të drejtë të krenohen me kontributin e tyre gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

9 maji – dita e fitores kundër fashizmit shënon triumfin e rezistencës popullore kundër makinerisë vrasëse, të emancipimit kundër errësirës ideologjike të nazifashizmit, të popujve kundër perandorisë, të barazisë kundër shfrytëzimit dhe shqiptarët ndjehen më krenarë se kurrë për kontributin e tyre në Luftën e Dytë Botërore.

REZISTENCA NDAJ PUSHTUESIT

Më 7 prill 1939 prill brigjet shqiptare u lanë me gjakun e bijve patriotë të Shqipërisë. Për sfidën e parë të rezistencës në Evropë ndaj nazifashizmit që bënë këta bij, shkruan edhe faqet e shtypit demokratik në Angli e kudo. Ato paralajmëruan popujt e botës për tragjedinë në afrim që i priste dhe treguan se si luftohet mënxyra fashiste. Të rënë të 7 prillit janë: Mujo Ulqinaku, Hamit Dollani, Haxhi Tabaku, Hysen Koçi, Isak Metalia, Ramazan Velia, Ismail Reçi, Ibrahim Osmani, Hamit Vashko Pas pushtimit prej Italisë në prill 1939, 100,000 ushtarë italianë dhe 11,000 kolonistë u vendosën në Shqipëri. Faza e parë, prill 1939-tetor 1941: karakteristike ishte qëndresa antifashiste. Pushtuesit u pritën jo me lule, por me "lulet" e vezmeve, me plumb ballit. Simbol i kësaj rezistence "Ishte Mujo Ulqinaku, një kapter, që lufton e vdes me nder".

KARAKTERI I REZISTENCËS KUNDËR FORCAVE PUSHTUESE

Rezistenca shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte një lëvizje kundër forcave pushtuese italiane (deri në 1943) dhe më pas kundër forcave gjermane në Shqipëri, lëvizje e cila çoi në çlirimin e suksesshëm të vendit më 29 Nëntor 1944.

Rezistenca në Shqipëri u bë aktive pas mposhtjes së italianëve në luftën kundër Greqisë, e cila filloi më 28 tetor 1940. Fillimisht slogani i ndërtimit të "Shqipërisë së Madhe", në të cilën italianët premtoan për të përfshirë një pjesë të madhe të Çamërisë, lejoi autoritetet kolaboracioniste për të mobilizuar disa mijëra vullnetarë për ushtrinë (përveç trupave të rregullt). Shembja e sulmit italian në Greqi shkaktoi një krizë midis trupave të rregullt, të cilët refuzuan të marrin pjesë në luftime të mëtejshme, si dhe në trupat vullnetare, të cilat u shpërbënë. Me kalimin e kohës, numri i grupeve luftuese dhe detashmenteve partizane, të përforcuara nga dezertorë të ushtrisë ishte rritur në mbi 3,000 burra. Në nëntor, në Lezhë, ushtarë kryengritës të cilët refuzuan të shërbenin më tej në njësitë italiane, zhvilluan një betejë kundër një ekspedite italiane duke vrarë 19 vetë dhe duke plagosur rëndë 30 të tjerë, para se të tërhiqeshin drejt maleve. Në të njëjtin muaj, një detashment partizan i zuri kurth një kolone transportuese italiane gjatë rrugës për në Gjirokastrë. Disa italianë u vranë. Më 17 maj 1941, një i ri i quajtur Vasil Laçi i bëri atentat mbretit Viktor Emanuelit III duke e qëlluar me armë.

KONFERENCA E PEZËS

Më 16 shtator 1942 u mbajt Konferenca e Pezës, e cila pati për qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacional-Çlirimtar. Konferenca e Pezës u mbajt në Pezë, një fshat pak kilometra distancë nga Tirana. Protagonistë të këtij kuvendi ishin 20 delegatë përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasa dhe shtresa me bindje politike nga më të ndryshmet. Pjesëmarrësit vinin nga rryma të ndryshme politike. Ndërmjet tyre ishin: Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Ismail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço. Nga PKS morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini (më vonë Hoxha). Kryetar i konferencës u zgjodh Ndoc Çoba dhe sekretar, Mustafa Gjinishi.

Në konferencë u diskutua organizimi i forcave në një luftë të përbashkët kundër okupatorit, organizim ky që mori emrin më vonë, Fronti Nacional-Çlirimtar.

NJOHJA E LUFTËS ANTIFASHISTE TË POPULLIT SHQIPTAR NGA ALEATËT E MËDHENJ

Po të mos kishte filluar e zhvillohej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar në humnerë bashkë me nazifashistët dhe do të ishin plotë-

suar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin edhe të shtetit shqiptar, për të cilat punonin edhe qeveritë mbretërore greko-serbe në egzil.

Ishte zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare që përfshiu gjithë Shqipërinë dhe që vetëm brenda vitit 1942 ishin krijuar 22 çeta partizane nga Konispoli në Jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri, jehona e kësaj lufte bëri që ministrat e jashtëm të Anglisë-Iden, i Bashkimit Sovjetik, Mollotov dhe i SHBA-Hell në Dhjetor 1942 të bënin deklaratën "që dëshëronin ta shihnin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të vendoset pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendoset në Shqipëri do të jetë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës".

Megjithëse në këtë deklaratë qeveria angleze mban-te një rezervë kur shprehej se "e sheh çështjen e kufijve shqiptarë pas Luftës si një çështje që duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes". Kjo deklaratë ishte mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në egzil që përgatisnin plane për copëtimin e Shqipërisë.

LUFTA E KODRËS SË KUQE

Lufta e Kodrës së Kuqe është një nga luftimet më heroike të zhvilluara në qytet gjatë vitit 1942. Vojo Kushi (shih) komandant i njësiteve guerile të Tiranës, bashkë me shokët e tij Sadik Stavileci dhe Xhorxhi Martini (shih) më 7.10.1942, u gjendën të rrethuar be-fasisht në shtëpinë e patriotës Ije Farka, bazë e rëndësishme e Partisë në lagjen Kodra e Kuqe të kryeqytetit. Komunistët kishin si armatim një automatik, tre revolverë dhe një sasi të vogël bombash dore. Në operacion merrnin pjesë 200-300 fashistë me 6 tanke e autoblanda, që drejtoheshin nga drejtori i përgjithshëm i policisë dhe prefekti i Tiranës. Armiku hapi zjarr me të gjitha llojet e armëve dhe bëri disa sulme për të mposhtur qëndresën heroike të komunistëve, por u thye me humbje. Pas 4 orë luftimesh ranë në fushën e betejës Xhorxhi e Sadiku. Kundër Vojo Kushit armiku hodhi në sulm dy tanke, që rrezuan murin e shtëpisë dhe çatinë e dhomës ku ai luftonte. Heroi u vërsul mbi njërin prej tyre, me qëllim që të hapte kapakun e çelikut dhe të asgjësonte ekuipazhin, por u godit për vdekje nga tanku tjetër. Epopeja zgjati 6 orë. Ajo çoi peshë popullin e Tiranës dhe pati jehonë të madhe në të gjithë vendin.

LUFTA E GJORMIT

Lufta e Gjormit është gjithashtu një nga luftimet më të mëdha, me pjesëmarrje të gjerë të forcave partizane dhe të popullit të qarkut të Vlorës gjatë fazës së parë të Luftës ANÇ. Më 30 dhjetor 1942 komanda italiane hodhi në drejtim të Mesaplikut dy regjimente milicësh e karabinierësh fashistë dhe më se një mijë

HISTORIA

Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar: e Dytë Botërore

mercenarë të tradhtarëve Halil Alija e Selim Kaloshi, të përforcuar me artileri, autoblanda dhe të mbështetur nga aviacioni, nën komandën e konsullit (kolonelit) Klementis. Operacioni, më i madhi deri atëherë, kishte për detyrë të asgjësoheshin partizanët, të çarmatosej dhe të terrorizohej popullsia. Komiteti qarkor i Partisë për Vlorën dha kushtrimin që armiku të pritej me luftë. Së bashku me partizanët, u ngritën më këmbë me armë në dorë rreth 1500 fshatarë trima të Vlorës, të Kurveleshit e të Mallakastrës dhe me qindra të tjerë u vunë në gatishmëri. Forcat kryengritëse u drejtuan nga Hysni Kapo (shih). Luftimet më të ashpra u zhvilluan në afërsi të fshatit Gjorm. Me luftën heroike të partizanëve dhe të popullit të armatosur, me gjithë tradhtinë e një çete balliste që dezertoi nga fronti i luftës, mësimja e armikut u ndal dhe u thye më 1 janar. Forcat partizane më 2 janar kaluan në sulm kundër forcave armike, që ishin rrethuar në fshatin Gjorm. Fashistët pësuan disfatë duke lënë në fushën e betejës më se 60 të vrarë bashkë me komandantin e operacionit, Klementis. Nga forcat kryengritëse mbetën 7 të vrarë e disa të plagosur. Lufta e Gjormit që një shembull i shkëlqyer i qëndresës popullore dhe i lidhjes së ngushtë të forcave partizane me popullin e armatosur. Një ndihmesë të shquar dhanë në këtë luftë gratë labe, që luftuan

krah për krah me burrat dhe djemtë e tyre. Kjo luftë, «epopeja e Vlorës», pati jehonë të thellë në gjithë Shqipërinë. Ajo i dha vrull luftës çlirimtare dhe thelloi krizën në radhët e fashizmit.

MIDIS DORËZIMIT TË ITALISË DHE PUSHTIMIT GJERMAN

Me rrëzimin e regjimit fashit të Benito Mussolinit dhe dorëzimin e Italisë në 1943, ushtria dhe policia italiane e vendosur në Shqipëri u thye. Luftëtarët shqiptarë shpartalluan pesë divizione italiane dhe rekrutët italianë u dyndën drejt forcave guerile. Komunistët morën kontrollin e shumicës së qyteteve jugore, përveç Vlorës, e cila ishte bastion e Ballit Kombëtar dhe nacionalistët e lidhur me LNÇ morën kontroll mbi një pjesë të mirë të veriut.

Agjentë britanikë që punonin në Shqipëri gjatë luftës ushqyen luftëtarët shqiptarë me informacion të pavërtetë se Aleatët po planifikonin një pushtim madhor të Ballkanit dhe i kërkonin grupimeve shqiptare që të bashkonin përpjekjet. Në gusht 1943, Aleatët bindën udhëheqësit komunistë dhe ballistë për të nënshkruar Marrëveshjen e Mukjes e cila do të koordinonte operacionet e tyre guerile. Dy grupimet me kalimin e kohës i dhanë fund çdo bashkëpunimi për shkak të një mosmarrëveshjeje mbi statusin e pasluftës së Kosovës. Komunistët donin ta rikthenin rajonin nën Jugosllavi pas luftës me shpresën se Tito do ta dorëzonte Kosovën mbrapsht paqësisht, ndërsa nacionalistët e Ballit Kombëtar kërkuan ta mbanin rajonin.

MARRËVESHJA E MUKJES

Marrëveshja e Mukjes ishte një marrëveshje e nënshkruar më 2 gusht 1943 në fshatin Mukje midis nacionalistëve të Ballit Kombëtar dhe ko-

munistëve të Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Të dy forcat do të punonin së bashku për të luftuar kontrollin e Italisë mbi Shqipëri. Megjithatë, një mosmarrëveshje u shfaq mbi statusin e Kosovës. Ndërsa Balli Kombëtar sugjeroi të luftohej për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, përfaqësuesit komunistë kundërshtuan fuqishëm. Balli Kombëtar i etiketoi komunistët si tradhtarë të Shqipërisë dhe shpesh i quante ata “qen të Titos” ndërsa partizanët akuzuan Ballin Kombëtar për bashkëpunim me Fuqitë e Boshtit, duke ndezur një luftë civile midis tyre që do të zgjaste një vit.

KRIJIMI I NJË USHTRIE HOMOGENE ÇLIRIMTARE

Më 17-22 shkurt 1943 në fshatin Labinot, u mbajt konferenca e parë e Partisë Komuniste Shqiptare. Vlerësimi i situatës politike dhe ushtarake në vend çoi në përfundimin se duhej të krijohesh një ushtri homogjene çlirimtare. Një vendim në lidhje me taktikat e luftimit gjithashtu u mor; udhëheqësit e njëjësive duhej të ndërmerren veprime me forca më të mëdha. Më 17 maj, 12 detashmente partizane nën komandën homogjene sulmuan një garnizon italian në Leskovik, i cili mbronte një kryqëzim rrugësh të rëndësishëm. Partizanët e rrethuan ngushtë qytetin dhe ndërmoren sulmin. Mbi 1,000 trupa italiane e kontrollonin qytetin. Beteja zgjati tre ditë. Komandanti i garnizonit kishte kërkuar mbështetje ajrore, por para se ajo të mbërrinte, partizanët e kishin marrë qytetin. Italianët humbën disa qindra ushtarë dhe sasi të konsiderueshme armësh dhe pajisjesh. Në fund të qershorit italianët filluan një ekspeditë ndëshkuese ndaj partizanëve në rajonet e Mallakastrës dhe Tepelenës. Dy mijë partizanë zunë pozicione mbrojtëse në qafat e maleve. Në përplasjen e parë, italianët u detyruan të zbramspen, por ata u rikthyen më 14 korrik me tanke, artileri dhe avionë. Pas katër ditësh luftime, partizanët kishin pësuar humbje të rënda dhe u tërhoqën në pjesët më të larta të maleve. Përgjithësisht, në periudhën maj-korrik italianët kishin humbur me mijëra vetë dhe shumë ishin plagosur.

Pas marsit 1943, LNÇ krijoi batalionin e saj të parë dhe të dytë të rregullt, të cilat rrjedhimisht u bënë brigada, për të vepruar përkrah njëjësive më të vogla ekzistuese. Rezistenca ndaj pushtimit u rrit shpejt pasi shenjat e dobësisë italiane u bënë të dukshme. Në fund të vitit 1942, forcat guerile shkonin jo më shumë se 8,000-10,000. Nga vera e 1943, kur përpjekja italiane u shemb, pothuajse e gjithë pjesa e brendshme malore kontrollohej nga njësitë e rezistencës.

Lëvizja Nacional Çlirimtare zyrtarisht themeloi Ushtrinë Nacional Çlirimtare në korrik 1943 me Spiro Moisiun si shef ushtarak dhe Enver Hoxhën si oficer politik. Kishte 20,000 ushtarë të rregullt dhe guerrilë në fushëbetë në atë kohë. Megjithatë, veprimtaritë ushtarake të UNÇ zhvilloheshin po aq kundrejt armiqve politikë të Partisë Komuniste, duke përfshirë parti liberale, nacionaliste dhe monarkiste të



Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore



- *Kur na ndajnë vetëm pak kohë nga 75-vjetori i përfundimit të luftës më të përgjakshme që kishte parë njerëzimi ndonjëherë, kacafytja kundër nazifashizmit, shqiptarët kanë të drejtë të krenohen me kontributin e tyre gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.*

paralufës, sa zhvilloheshin kundrejt pushtuesve.

LIDHJET ME ALEATËT DHE NDIHMA

Britanikët ishin përpjekur për të organizuar operacione ndërlidhëse në Shqipërinë e pushtuar prej Italisë në fillim të 1941, nga ajo që atëherë ishte një Jugosllavi neutrale. Këto tentativa u braktisën shpejt pasi Italia dhe Gjermania pushtuan Jugosllavinë. Pas kësaj, nuk u bë asnjë përpjekje për të kontaktuar grupet e rezistencës shqiptare deri më 17 prill 1943, kur M.O.4, një degë e organizatës ndërlidhëse SOE, dërgoi një mision të komanduar nga Kolonel Toger “Billy” MacLean, me Major David Smiley si i dyti në komandë.

Në vend që të hynin pa asnjë ide në mënyrë të menjëhershme në Shqipëri, misioni u vendos në Greqinë veriperëndimore ku grupe britanike po operonin bashkë me guerilët grekë. Nga atje, ata shkuan në Shqipëri në këmbë ose me mushka.

Pas disa përpjekjeve të dështuara, misioni bëri kontakt me LNÇ. Furnizimi i parë me armë dhe pajisje u mor në 27 qershor. Furnizime të mëtejshme u bënë për LNÇ të cilët ishin grupi dominant në Shqipërinë jugore dhe u përdorën për të pajisur “Brigadën e Parë Partizane”.

Më vonë në 1943, SOE e rriti madhësinë e misionit në Shqipëri. Komandanti i ri ishte Brigadieri Edmund Frank Davies i Pushkëve Mbretërore të Ulsterit (mori pseudonimin “Trotsky”) në Sandhurst për shkak të “bolshevizmit të disiplinuar” në karakterin e tij, me Kolonel Toger Arthur Nicholls si Shef Shtabi.

MacLean dhe Smiley u tërhoqën në bazën e re të SOE në Bari për të raportuar. Megjithatë ata vunë re se komunistët e LNÇ ishin më tepër të interesuar për të siguruar pushtetin politik pas luftës sesa për të luftuar gjermanët, ata rekomanduan që SOE të vazhdonte që t'i furnizonte, ndërsa përpiquej për të arritur një marrëvesh-

je midis LNÇ dhe grupeve të tjera të rezistencës. Në janar 1944, gjermanët sulmuan dhe morën zyrat qendrore të misionit britanik. Brigadieri Davies u zu rob ndërsa Kolonel Toger Nicholls vdiq nga tronditja pasi shpëtoi të mbijetuarit.

Gjatë pjesës së mbetur të 1944, SOE vazhdoi të furnizonte LNÇ, pavarësisht ankesave të MacLean dhe Smiley, që tani ishin duke vepruar në grupe ndërlidhëse me grupin e Abaz Kupit dhe Ballin Kombëtar në Shqipërinë e veriut, se LNÇ po i përdorte këto armë kundër armiqve politikë dhe jo gjermanëve. Smiley, MacLean dhe Julian Amery u evakuan në Itali në fund të tetorit. SOE refuzoi për të evakuar Abaz Kupin në të njëjtën varkë dhe ai u arratis vetë prej vendit, duke u marrë prej një anijeje të Flotës Mbretërore në Adriatik.

LANÇ, KRENARI KOMBËTARE

Ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë.

Ne krenohemi me 70 mijë partizanët që bënë atë luftë vendimtare për çlirimin e vendit.

Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane. Në momentin historik populli shqiptar, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetonte në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës.

Në bazë të kësaj lufte e sakrificave që bëmë, ne siguruam jo vetëm pavarësinë e Shqipërisë por të drejtën e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje e të shqiptarëve kudo që jetojnë, të drejtën për të qëndruar në trojet e tyre etnike. Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë.

NDERIM

Për herë të parë, një rrëfim i jashtëzakonshëm i shkrimtarit Petro Marko për dëshmorin nga fshati Sohodoll i Dibrës

RIZA TAHIR TITINI - Dëshmori i LANÇ që vdiq në kampin e Mat'hauzenit

**Nga Sakip Cami
Shuaip Met'hasani**

Riza Titini është i datlindjes 1917. Është lindur në fshatin Sohodoll të Dibrës. Babai i tij Tahir Titini ka qenë i martuar me Zahide Zebin nga Borovjani. Rizai ishte nip tek Zebi i Borovjanit. Rizai dhe Zahidja patën katër fëmijë, tre djem dhe një vajzë, Samiun, Shyreten, Rizain dhe Lutfiun. Shyretja ka qenë e martuar tek fisi Makishti, bazë e LANÇ, shtëpia që strehoi partizanen Ollga Mati nga Librazhdi. Vëllai i Rizait, Lutfiu e dërgoi fshahurazi tek motra. Ngjarja që do ju tregojmë më poshtë është pikërisht kjo.

NUSJA "PARTIZANE" QË KALOI PËRMES NAZISTËVE

Nuk është skenari i filmit "Nusja dhe shtetrrëthimi" por ngjarja e vërtetë që ka ndodhur në fshatin Sohodoll të Dibrës në korrik të vitit 1944.

Gjatë luftimeve të Brigadës I S në Dibër për çlirimin e Peshkopisë, gjermanët kapën rob një partizane dhe po e torturonin. Jo vetëm e torturonin, por edhe talleshin me të. Partizania njihej me emrin Zenepe, por në fakt quhej Ollga dhe ishte nga Librazhdi. Ishte 22 vjeç. Një nga dibranët që shoqëronte gjermanët nuk e pranoi këtë poshtërim. Por nuk mund të dilte drejt për drejt. Natën, kur gjermanët u

larguan dhe ja lanë nën ruajtje ai ja dorëzoi Lutfi Titinit (vëllait të Rizait) për ta larguar dhe për ta fshehur. Lutfiu e mori dhe çoi fshehurazi tek Ramiz dhe Halit Makishti.

I porositi që të ruanin me kujdes, ta vishnin si vajzë dibrane dhe kur të vinin partizanët e Brigadës I S, tua dorëzonin atyre. Ramizi ashtu bëri. E veshi Zenepen me rrobat karakteristike të grave dibrane, me fustan, shami, çorape e opinga zifti, me përparëse dhe me drapër në dorë për të korrur grurë. Tek Ramizi qëndroi deri me 13 gusht, deri sa erdhi Brigada I S në Limjan. Me datën 13 gusht e veshi Zenepen me perçe, ja mbuloi fytyrën dhe e shoqëroi për Limjan bashkë me nipin e tij.

Patrulla gjermane dhe shqiptari përkthyes e ndaloi. -Po ju natën ku shkoni kështu?

-E kam nusen e djalit, e kam të sëmure dhe do ta dërgoj tek Teqja e Limjanit. Amani, mos më vononi! Përkthyesi përktheu dhe patrulla e lëshoi.

Kur arriti partizania në shtabin e Brigadës, ata u habitën sepse e dinin të zhdukur. Shtabi i jep Ramizit një letër që vërtetonte se Ramiz Makishti kishte shpëtuar jetën e një partizanie. Këtë letër Ramizi e vuri në përdorim në vitin 1967, për një hall që ju krijua.

Në vitin 1972 partizania Ollga erdhi në Sohodoll dhe falenderoi familjen që e kishte strehuar. Edhe sot miqësia midis dy familjeve ka vazhduar.

Në vitin 1946 Nesim Fishti nga



Vrenjti i Dibrës tregon se është takuar me Petro Markon në Kantjerin e Tharjes së Kënetës së Maliqit.

Petroja i afrohet Nesimit, pasi e kupton që ishte dibran. Desha t'ju pyes për një dibran që e kam patur shok ushtrie nga Sohodoll i Dibrës në Gjirit të Greqisë gjatë luftës italo-greke. Quhej Riza Tahiri. Por mbiemrin e kishte Titini. Ishte djalë flori, trim e atdhetar. Dallohej nga të tjerët. Qëndruam disa kohë bashkë derisa erdhi dezertimi në masë i ushtarëve shqiptarë.

- Kur ishte në burg në Shkodër, vazhdon tregimin Petro Marko, gjatë bisedës me Nesim Fishtin, Rizai plagosi një marshall italian sepse fyte Shqipërinë dhe flamurin shqiptar. Për këtë e dërguan në një kamp internimi shfarosës në Gjermani. Kam dëgjuar se e kanë vvarë dhe ja kanë djegur kufomën, mbyll bisedën me sytë me lot Petro Marko.

KUSH ISHTE RIZA TAHIR TITINI?

(Një rrëfim për herë të parë për dëshmorin dibran që edhe sot është pa varr) Sipas arkivit të MM Riza Titini ka qenë i internuar në kampin e Mathauzenit dhe ka vdekur në vitin 1945. Eshtrat e tij nuk janë kthyer në

vendin tonë. Është shpallur dëshmor i atdheut me Vendimin Nr 50 të datës 30.06.1972 të Kom. Ekz. Këshillit të Rrethit Dibër.

Rizai mobilizohet ushtar në shtator të vitit 1939 dhe dërgohet në malin e Taraboshit në Shkodër. Një ditë gjatë stërvitjes konfliktohet me marshallin italian që drejtonte stërvitjen sepse ai e fyen rëndë si shqiptar.

_Kemi ardhur ne nga Italia, që t'ju bëjmë njerëz ju se jeni egërsira pa shkollë, pa kulturë, pa shtet, i ka thënë marshalli italian në sy të të gjithëve.

Kaq ka mjaftuar që Rizai ta godasë e ta bëjë për vdekje marshallin italian.

-Kush je ti more që vjen dhe na tregon ne se çfarë jemi. Ne jemi komb më i kulturuar dhe më fisnik se ju.

Rizain e burgosin menjëherë dhe e dërgojnë në internim në ishullin e Ustikës në Itali. Edhe në Itali edhe në luftën italo-greke Rizai ka qenë së bashku me shkrimtarin e shquar Petro Marko.

Nga internimi e dërgojnë në luftën italo-greke në Greqi.

Pas dezertimit nga lufta italo-greke Rizain e dërgojnë në një kamp internimi në Gjermani ku nuk u kthye më.



RRUGËTIMI

Kontributi i të çmuar i shqiptarëve të Kosovës për shpëtimin e hebrenjve

Tafil Boletini në mbrojtje të hebrenjve

Nga Moza Boletini*

Sipas materialeve arkivore dhe disa dokumentave që më dërgoi Gazmend Boletini nga Mitrovica, bëhet fjalë për shpëtimin e hebrenjve në Prefekturën e Elbasanit në vitin 1943, ku në qendër ndodhet portreti i intelektualit e patriotit Tafil Boletini, në atë kohë Prefekt i qytetit të Elbasanit. Ky material pasqyrohet edhe me disa foto të hebrenjve mbijetuar në atë qytet falë përpjekjeve të vetë Prefektit Boletini. Aty dhe në disa nënshkrime të tjera të tij shihen në detaje lista me emra fëmijësh, të rriturish, letër njoftimet e tyre, që për t'i shpëtuar gestapos, me iniciativën e Tafil Boletinit ju ndryshohet vendlindja, profesioni. Kërkesës së kuesturës gjermane për emigrantet atë kohë për Elbasanin, Tafil Boletini i përgjigjet me një shkresë zyrtare ku shkruan përbri emrave, e datëlindjeve të hebrenjve, edhe profesionet: lindur ne Prishtinë; profesioni: tregtar, shtëpiake, nxënës, e kështu me rradhë.... Letra i drejtohet Ministrisë së Brendshme në Mars 1943 dhe mban firmën e Prefektit Tafil Boletini. Këto janë ngjarje të jetuara, si pjesë e historisë që tregojnë se edhe shqiptarët e Kosovës kanë dhënë një kontribut të çmuar për shpëtimin e hebrenjve dhe këto janë fakte të pamohueshme.

Tafil Boletini ishte diplomuar në Turqi për jurist e avokat. Nip e luftëtar besnik i heroit Isa Boletini që e ka shoqëruar në të gjitha betejat, luftërat e takimet e tij me politikanët e kohës, shqiptarë e të huaj. Ka qenë prezent me Isën në udhëtimin kalorsiak deri në Vlorë për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, ku rrugës që nga Mitrovica e largët deri në Vlorë përveç motit të keq, hasën në banda kusarësh e prita të turko-malazezëve. Isa e mbante afër



në këmbë të vëllait të tij më të madh Ahmetit, që shkajau e turku e vrau për ta hequr qafe, pasi edhe ai ishte një trim i vërtetë, strateg e njeri i mençur.

Tafil Boletini ka lenë pas mjaft kujtime për familjen, axhën Isë, i cili e rriti, edukoi dhe shkolloi, si birin e tij. Edhe në momentet e fundit të jetës së Isës

në Podgoricë, ka qenë prezent dhe si i mbijetuar i asaj masakre, ka folur për pabesinë e konsullit francez dhe vrasjen nga forcat serbo sllave të Isa Boletinit, djemve, nipave e mbështetësve të kauzës së tij të drejtë.

Tafil Boletini si daja i babait tim, deri në ditën kur humbi jetën aksidentalisht në Tiranë, vinte shpesh në familjen tonë. Jetonte tek e bija Shemsija e familja e saj, deri sa u largua nga kjo botë, e na la pas dhimbje të madhe. I pëlqente dhe e tërhiqte biseda me tim atë, si dy intelektualë të mirëfilltë e si prindi me të birin flisinin qetë, shtruar për hallet e jetës, familjes duke përmenduar edhe ngjarje të luftës. Kujtonin Ahmetin, Isën e plot bij e trima të asaj familje e luftëtarëve të tjerë që shkrinë çdo gjë për Kosovën e popullin shqiptar.

Isha fëmijë, por shpesh qëndroja pranë tyre e dëgjoja me vëmendje, se si ishte ndërtuar historia e jeta e familjes tonë. E kisha xhan Dajë Tafilin, vëreja që edhe ai më donte shumë. E dija ditën kur vinte tek ne e me padurim prisja të dëgjoja prej tij ngjarje dhe histori patriotike. Pra një pjesë e familjeve hebre në Shqipëri janë shpëtuar edhe nga Prefekti i Elbasanit në vitin 1943, juristi Tafil Boletini. Falenderoj të afërmin tim Gazmend Boletini për dërgesën e këtyre materialeve e disa dokumentave të tjera që dëshmojnë përkujdesjen që ka treguar Tafil Boletini në mbrojtje të popullit hebre në vitin 1943 në Elbasan. Gjithashu vlerësoj punën e përkushtuar e të shkëlqyer të Gazit që bën çdo ditë në Muzeumin Isa Boletini në Mitrovicë, vend historik që vizitohet çdo ditë nga personalitete të botës, amerikane etj, si dhe turistë dashamirës të çështjes shqiptare.

***SHBA, Shkurt 2020**

NDERIMI

Ish oficeri shembullor i marinës Selman Rama do të kujtohet gjithnjë me nderim të veçantë

Nga Zaim SEFA*

Personaliteti i një ushtaraku me formin e karrierë të shkëlqyer siç ishte Selman Rama nuk mund të përkruhet në pak rreshta. Gjithsesi le të shërbejnë këto pak radhë si një përkujtimore për të.

Selman Rama vinte nga një familje fisnike nga Muhurri i Dibrës. Pasi kreu me rezultate të shkëlqyera studimet në Shkollën "Skënderbej" dhe Shkollën e Lartë të Marinës në Vlorë shërbeu në Forcat e Armatosura, në repartet mbështetëse të specialiteteve të veçanta.

Po kush është në të vërtetë Selman Hidër Rama?

Ka lindur në Muhurr, Dibër më 01.09.1944. Shkollën fillore dhe atë 7 - vjeçare i mbaroi në fshatin e lindjes, me rezultate të mira. Me mbarimin e shkollës 7 - vjeçare pati fatin, t'i dalë e drejta e studimit për në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" Tiranë, studime të cilat i mbaroi në vitin 1962 dhe po atë vit filloi shkollën e lartë të marinës në Vlorë, ku u diplomua në vitin 1965. Gjatë viteve në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe atyre studentore në Shkollën e Lartë të Marinës, Vlorë, Selmani manifestoi inteligjencë e pjekuri, aq sa fitoj dashurinë e respektin e pedagogëve dhe të shokëve studentë. Në Flotën Luftarake-Detare punoi për 36 vjet (deri sa doli në pension), në detyra të ndryshme, si shef organi deri në vitin 1968 dhe nga 1968 -1978,

shef i armëve të nënujshme në Bazën Ushtarake-Detare, Durrës. Kuadri i përgatitur me dije e njohuri të larta profesionale, në vitet 1978 -1980 do të shërbente edhe si pedagog i armëve të nënujshme në Shkollën e Lartë të Marinës, Vlorë, për t'u kthyer pranë familjes (1980 -2001) si specialist i armëve të nënujshme në distriktin detar Durrës. Selman Rama shërbeu me devotshmëri e përkushtim në të gjitha këto funksione, duke e mbajtur me nder emrin e skënderbegasit dhe të familjes së tij nga fshati i bukur Muhurr, që shtrihet në luginën e Drinit të Zi, në hapësirën mes dy maleve më të lartë të vendit, Korabit e Runjës hijerëndë e kreshnike. Si i tillë, Selman Rama bën pjesë në plejadën e ushtarakëve shqiptarë që u shkolluan në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe në Shollën e Lartë të Marinës, Vlorë dhe që kontribuan për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare.

Pas vitit të mbrapshtë '97, kur ushtria shqiptare përsoi disfatë të rëndë, koloneli dibran u angazhua në Flotën Luftarake Detare, Distrikti i Durrës. Me një përkushtim të veçantë, si specialist i talentuar dhe ushtarak i kompletuar ringriti reparte dhe nënreparte të minave dhe ruajtjes së tyre në gjithë vijën bregdetare, me qendër të Porto Romano dhe Kepi i Palit. Përforcoi të gjitha nënrepartet nga Shëngjini e deri në Porto-Palermo. Instruktroi më së miri të gjitha specialitetet e minim-çmimit në këto zona, duke pas nën kontroll dhe përdorim të specializuar, jo vetëm minahedhësit, por gjuejtësit në Dragominë në Katrosiloruset; vendosi në sigurim teknik



gjithë arsenalin luftarak mina, predha e municione të tjera të gjujteseve. Me autoritetin e një ushtaraku të kompletuar, me sjelljen e një malësori autoritar, me pak fjalë e shumë punë, Selman Rama e mbylli karrierën e tij si një ushtarak e intelektual i shquar, duke lënë kujtime të paharruara të cilido që punoi me të.

I tillë do të kujtohet ai, jo vetëm nga Familja e tij e nderuar në Durrës e në Muhurr të Dibrës, por edhe nga shokët e miqtë e shumtë që i deshi, e deshën dhe ju mungon aq shumë.

***Anëtar i Këshillit Drejtues Kombëtar të OBVL**

PERKUJTIMORE

31 vjet nga greva e minatorëve të Trepçës

Bashkim Hisari



Me Kushtetutën e vitit 1974 Kosova për herë të parë themeloi kuvendin si organin më të lartë ligjvënës, pushtetin e ekzekutiv – që quhej Këshilli Ekzekutiv, kishte sistemin gjyqësor, si dhe kishte Gjykatën Kushtetuese. Mirëpo, në fillim të vitit 1989, në Kosovë u krijua një situatë dramatike. Kuvendi i Serbisë propozoi amendamente kushtetuese për heqjen e pavarësisë së institucioneve të Kosovës, dhe riemërimin e Kosovës në Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Me këtë faktikisht u kërkua ndërrimi i kushtetutës së vitit 1974. Duke par këtë qëllim, në shkurt të viti 1989, shqiptarët e Kosovës u ngritën përsëri në protestë kundër propozimit nga Serbia.

Me 20 shkurt 1989, minatorët e Trepçës të horizontet 11 në Stantërg u ngujuan, u futën në zgafellën e minieres, në horizontin e 8, me shpresë se do të shpëtojnë statusin e Kosovës dhe kundërshtonin regjimin e S. Millosheviçit i cili kishte filluar të suprimojë të drejtat e shqiptarëve duke hequr, paraprakisht kushtetutën e Kosovës e pastaj duke filluar edhe me diskriminimin kombëtar të shqiptarëve. Në shenjë solidarizimi, edhe puntorët e studentët shqiptarë u futën në grevë urije që zgjati 8 ditë. Në bisedat e zhvilluara me minatorët, grevistët dhe me udhëheqësit e tyre, u evidentuan kërkesat, të cilat ishin të thjeshta dhe koncize, por, të njohura edhe më parë, vetëm që tash ishin edhe të plotësuar. Kërkesat e minatorëve ishin:

1. Garantimi i themeleve të Kushtetutës të viti 1974. (Qëndrimet e paharmonizuara me amendamentet e Kushtetutës të mbeten ato që janë në fuqi me Kushtetutën e vitit 1974).

2. Të shpallet regjistri i organizatorëve të tubimeve të nëntorit-ngase

të gjithë minatorët ishin organizatorë të tubimeve dhe të marsheve protestuese, sepse në mesin e tyre nuk kishte liderë as organizatorë të veçantë.

3. Të merren në përgjegjësi ata të cilët kanë hartuar propozimin e ligjit për pensionimin e punëtorëve të arsimit para kohe në Krahinë.

4. Rrahman Morina të ndërrohet nga pozita e kryetarit të Kryesisë të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, sepse nuk e ka mbajtur fjalën që ua ka dhënë minatorëve. Poashtu të japin dorëheqje Ali Shukriu dhe Husamedin Azemi.

5. Të ndërpritet politika e gabuar ndaj popullit shqiptar.

6. Menjëherë të vijë dr. Stipe Shuvari, Slobodan Milosheviç dhe Ali Shukriu. (Minatorët kërkojnë që këtyre t'u flasin drejtpërdrejt për politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve, të cilës ata po i kontribuojnë).

7. Nuk ka organizatorë të veçantë, por të gjithë jemi organizatorë.

8. Personat e panjohur në këtë moment të mos hyjnë në zgafelle.

9. Të njoftohen përfaqësuesit e krahinave dhe të republikave për gjendjen në Kosovë.

Me zhvillimin e mëtejshëm të grevës, minatorët paraqitën kërkesën e 10-të plotësuese, me të cilën kërkohej internacionalizimi i çështjes së Kosovës në OKB.

Grevat e minatorëve, protestat e qytetarëve dhe rezistencën e tyre ndaj presioneve që vinin nga nacionalistët serbë të cilët ato i paraqitnin si armiqësore dhe antijugosllave. Me vlerime të tilla S. Millosheviç arriti të bindi edhe një pjesë të kreut federativ që ia mundësoi të mabilizoj edhe mehanizmat e pushtetit federativ që të rreshtohen kundër shqiptarëve dhe Kosovës, kinse për të mbrojtur Jugosllavinë.

Por, greva e minatorëve të "Trepçës" ka qenë e do të mbetet përgjithmon ngjarje me rëndësi historike e

klasës punëtore të Kosovës, mbetet në histori ngjarje revolucionare e minatorëve trima të "Trepçës". Marshimi i mençur revolucionar prej "Trepçës" e deri në Prishtinë në këmbë në ato ditë të ftohta me shi, ishte një shprehje e paparë deri atëherë. Ishte revoltë e minatorëve kundër të gjithë atyre që ndërmorën gjithë ato masa dramatike e reacionare për ta rrënuar Autonominë e Kosovës e për ta shkelur lirinë e të drejtat e popullit shqiptar të Kosovës ...

KUNDËR MINATORËVE TË TREPÇËS 30 MIJË POLICE SERB.

Duke parë këto veprime, S. Millosheviçi iu rikëthye politikës së mitingjeve. Organizoi një miting të madhë në Beograd me ç'rast u krijua një atmosferë që detyroi Kryesinë e shtetit të shpalli gjendjen e shtetërit të Kosovës. U krijua një disponim i ndezur dhe skajshmërisht ekstrem kundër shqiptarëve, edhe pse me kërkesat në protesta dhe greva u solidarizua pjesa dërmuese e popullit të Kosovës. Në të njetën kohë, serbët organizonin mitingje protestuese për rjedhën e ngjarjeve në Kosovë dhe kundër tubimeve të solidaritetit me minatorët e "Trepçës". Udhëheqësia serbo-jugosllave tregoi indiferencë të pakuptueshme e shqetësuese për mungesën e dëshirës për gjetjen e rrugës së drejtë për Kosovën, për refuzimin e dialogut me popullin e vetë, për mbylljen e syve dhe të veshëve para kërkesave të shqiptarëve të Kosovës të cilët dëshironin të kenë të drejta të barabarta si edhe popujtë të tjerë në Jugosllavi. Serbët, arrestuan liderin politik të shqiptarëve Azem Vllasin, drejtorët e "Trepçës" Aziz Abrashin dhe Burhan Kavaja dhe 14 përkrahësit e tyre. Në këtë kohë, në Kosovë, u vendos gjendja e jashtëzakonshme dhe ora policore nën presionin e 30 mijë policëve të sjellur nga Serbia.

Kërkesave të minatorëve të "Trepçës" përveq puntorëve, nxënësve, studentëve e shumë qytetarëve, iu bashkuan edhe intelektualët e shkrimtarët të cilët organizonin mbrëmje proteste.

Në mbrëmjen protestuese të 26

shkurtit 1989, akademik Gazmend Zajmi, e lexoi prozën "Çaste e mote" kushtuar minatorëve të "Trepçës" dhe të mbarë Kosovës. Ai ndër tjerash tha: "Shokë minatorë të "Trepçës" dhe minatorë të mbarë Kosovës, në lumin e gjerë të solidaritetit me Ju, pranoni edhe zërin tim modest prej individit, prej akademiku e kompozitori, të solidaritetit dhe të lutjes për shpëtimin e shëndetit dhe të jetës Suaj që është pakrahasimisht më e shtrenjtë se e tërë korja e mbufatur politike e këtij nënqielli dhe e tërë rruzullit. Kush do të mund ta merrte me mend se kryeneçësia dhe arroganca politike është më e vrazhdë, më kërcënuese, më gërryese... se kataklizmit natyrorë mbi jetën e njeriut..."

Fjalë përkrahjeje e thirrje për shpëtimin e shëndetit dhe të jetës së minatorëve vinin edhe nga disa njësi federale të ish-Jugosllavisë, sidomos nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, por edhe nga Maqedonia, ku një numër i madh i shqiptarëve thuaja ishte ngritur në këmbë për mbrojtjen e vëllezërve të tyre në Kosovë. Të gjithë bënë përpjekje, kërkonin ndërhyrjen për dialog e zgjidhje. Të gjithë u drejtoshin minatorëve që të praninin të dilnin nga zgafellja, të bisedonin jashtë për kërkesat e tyre. Në Kosovë bëheshin tubime, protesta, kërkoheshin zgjidhje. Punëtorët, studentët, nxënësit, shkrimtarët etj., në tubimet e tyre protestuese i përkrahnin kërkesat e minatorëve, të cilat, në të vërtetë, ishin kërkesa gjithëkombëtare të shqiptarëve të Kosovës dhe hasnin në përkrahje edhe të shqiptarëve të trojeve të tjera etnike në ish-Jugosllavi. Minatorët nuk praninin të dilnin nga zgafella pa marrë garancion nga udhëheqja më e lartë shtetërore e politike e ish-Jugosllavisë, e Serbisë dhe e Kosovës se do të plotësoheshin kërkesat e tyre dhe se Kosovës do t'i garantohej e paprekur pozita e saj e sanksionuar me Kushtetutën e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë-të vitit 1974.

Por, në fjalimet e udhëheqësve partiakë të Kosovës, të Serbisë e të Jugosllavisë, shihej çartë se janë kundër kërkesave të minatorëve të "Trepçës" dhe të klasës punëtore të Kosovës. Fjalimet e tyre treguan qartazi se ndërrimet në Kushtetutën e Serbisë e ngushtojnë dukshëm autonominë e Kosovës, që ishte në kundërshtim me deklarinimin e lire të popullit shqiptar të Kosovës.

Gjatë grevës së përgjithshme të udhequr nga minatorët, të gjitha tubimet publike në Kosovë u ndaluan. Serbia filloi të aplikoj ligjin e ashtuquajtur "obligimi për punë" të miratuar enkas nga Kuvendi i Serbisë dhe vendosi masat e dhunshme, të cilat minatorët e "Trepçës" nuk i pranuan dhe vendosën që mos ti zbatonin urdhrat e tyre. Në përpjekje për të trembur protestuesit, me rreth 100 tanke dhe 15.000 trupa,

(Vijon në faqen 7)



IN MEMORIAM

Xhavid Nimani ishte burrështetas i drejtëpërdrejt, autoritativ, i matur njeri modest, miqësor

NË PRISHTINË U SHËNUA 100 VJETORI I LINDJES SË XHAVID NIMANIT

Nga Drita Rexhepi

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes, në Prishtinë u përkujtua figura dhe veprimtaria e Xhavid Nimanit. Në tubim muarrën pjesë antarët e familjes, veteranë të LANÇ-së dhe pasardhësit e tyre, antarët e Kryesisë së Organizatës së veteranëve të LANÇ-së të Kosovës dhe të degëve të saj nga Prishtina, Prizreni, Gjakova dhe Vitija si dhe shumë bashkëpunëtor dhe bashkëkohanik të tij. Xhavid Nimani ka qenë figurë e veçant, dhe me krenari mund të flitet për formimin, frymën, qëndrimet, vlerat dhe arritjet e tij për popullin shqiptar dhe për Kosovën. Ishte ndër kuadrot më të shquara shkolluar në Shqipëri, pjesmarrës dhe organizator i LANÇ-së dhe udhëheqës i Kosovës që kontriboi për lirinë dhe pavarësinë kombëtare.

Duke folur për jetën dhe veprën e Xhavid Nimanit, kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-së të Kosovës, Zija Mulhaxha për veç tjerash tha: "Xhavid Nimani lindi në janar të vitit 1919. Si fëmijë shkoi për t'u shkolluar në Shqipëri, ku kreu shkollën normale në Elbasan. Në Lëvizjen Naciona-



lçlirimtare u bashkua si nxënës. Ishte në mesin e të rinjëve Kosovar që u gjendën në bërthamën e kësaj lëvizjeje. Në LANÇ ishte në udhëheqjen më të lartë politike dhe ushtarake. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe çlirimit të Kosovës, Xhavid Nimani u angazhua menjëherë në ndërtimin e pushtetit popullor. Fillimisht në sektorin e arsimit e pastaj në ndërtimin ekonomik të Kosovës të cilën e konsideronte si bazë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës në

nxjerrjen e saj nga prapambeturia e trashëguar dhe varfria e imponuar. Me angazhimin e tij dhe shokëve të ngusht u ndërtuan dhe u vunë në funksion disa objekte vitale ekonomike në Kosovë" tha Mulhaxha dhe shtoi: "Xhavid Nimani ishte burrështetas i drejtëpërdrejt, autoritativ, i matur njeri modest, miqësor, gazmor në biseda dhe me plotëkuptimin e fjalës një zotëri i vërtet".

Ndërkaq, nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Bashkim Hisari tha se

tubimi i sotëm është "aktivitet i rëndësishëm, sepse nuk ka të bëjë jo vetëm me ceremoninë e shënimit të 100 vjetorit të lindjes së Xhavid Nimanit, por është edhe moment që të kujtohet 75 vjetori i çlirimit nga okupimi nazifashist, ngjarje kaq madhore në historinë e shqiptarëve ku rreth 53.000 kosovar u renditën me dinjitet në krahun e fitores botërore". Hisari përmendi disa çështje shumë të rëndësishme të inicuar nga Xhavid Nimani që kanë lane gjurmë të pashlyer në jetën shoqërore politike të shqiptarëve në Kosovë. Veçmas theksoi se ai fuqimisht ka mbështetur Vendimet e Konferencës së Bujanit, ku ishte pjesmarrës.

Hisari përkujtoi se Kryesia e RSFJ dhe Komiteti Qendror i LKJ, ngjarjet e vitit 1981 kishin vlerësuar si kundërrevolucionare dhe si lëvizje nacionaliste seperatiste, mirëpo Xhavid Nimani nuk ishte pajtuar me këto vlersime dhe në qershor të vitit 1981, ai si kryetar i deriatëhershëm i Kryesisë së KSA të Kosovës kishte dhanë dorëheqje në këtë funksion.

Figurën e Xhavid Nimanit përkujtuan edhe bashkëpunëtorët e tij Qerim Gashi dhe Muhamet Mustafa.



31 vjet nga greva e minatorëve të Trepçës

(Vijon nga faqja 6)

u organizuan manovra në Kosovë. Si ndëshkim ndaj minatorëve pasuan masa të ashpëra kundër minatorëve. Sipas evidencës së ish kryetarit të Sindikatës të Minatorëve Ibrahim Zogjani, pasojat e kësaj fushate për punëtorët e Trepçës ishin:

Afro 8 mijë minatorë u larguan nga puna, u rrahën, burgosën, izoluan...

- 7.641 minatorë (dhe punëtorë tjerë në miniera) u larguan nga puna,
- 3.388 prej tyre u dënuan me burg (prej 30 ditë deri në 14 muaj),
- 333 u rrahën dhe malltretuan në forma të ndryshme,
- 8 prej tyre përjetuan atë "izolim" famëkeq së bashku me shumë të tjerë,
- 51 punëtorëve iu morën banesat, mbetën pa kulm mbi kokë,
- 219 u larguan nga Kosova për shkaqe ekonomike (me familje),
- 491 u larguan nga Kosova për të njëjtat shkaqe (pa familje),

- 203 kërkuan azil politik në shtete të ndryshme dhe
- 1915 prej tyre mbeten pa kurrfarë të ardhurash.

Në vrrullin e grevave në vitin 1989, dhe të kërkesave serbe që të suprimohen të gjitha normat kushtetuese, me të cilat përcaktohen të drejtat autonome të krahinave, intelektualët, punëtorët shkencor dhe kulturorë të Kosovës ishin ndër të parët që u solidarizuan me kërkesat e grevës së minatorëve të Trepçës për të mbrojtur autonominë e Kosovës dhe pozitën e saj kushtetuese.

Në ditën e dytë të grevës, më 21 shkurt 1989, kur gjithnjë e më shumë nepër gazeta, publikime të ndryshme kulturore dhe shkencore dhe në praqitje tjera publike të forcave antishqiptare që kërkonin suprimimi e të drejtave autonome dhe injorohej çdo propozim nga Kosova, u prezantua Apeli e 215 intelektualëve, dhe punëtorëve shkencorë dhe kulturorë të shqiptarëve të Kosovës për mbrojtjen institucionale dhe kërkuan afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës.

HOMAZH

TAHIR ADEM HAJREDINAJ, intelektuali që e nderon gjithë Tropoja

Ai ishte dhe do të mbetet intelektual shembullor që e nderonte gjithë Tropoja, pasi karakterizohej nga thjeshtësia, mirësia e komunikimi i virtytshëm që përbëjnë dimensionin e tij njerëzor



Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndihmëse dhe e hapur për partizanët.

Pas mbarimit të shkollës, Tahiri u

angazhua dhe dha ndihmë të madhe në punën me rininë.

Në vitin 1951, në vlerësim të aktivitetit, aftësive dhe përkushtimit qytetar, Tahiri emërohet Drejtues në Sektorin e Tregtisë.

Gjatë viteve 1975-1978 kreu detyrën e Shefit të Tregtisë në Komitetin Eklzekutiv të Rrethit Tropojë.

Në vazhdim deri në vitin 1992 ka punuar me ndershmëri e profesionalizëm në ndërmarrjet më të mëdha në nivel drejtuesi, si në Ndërmarrjen Tregtare, në NFP Fierzë, në Ndërmarrjen Komunale dhe Ndërmarrjen Bujqësore.

Tahiri dhe bashkëshortja e tij, Bute krijuan një familje të mrekullueshme me tre djem e dy vajza, familje e cila gëzon respekt dhe reputacion në gjithë rrethin e Tropojës e më gjerë.

Ai ishte dhe do të mbetet intelektual shembullor që e nderonte gjithë Tropoja, pasi karakterizohej nga thjeshtësia, mirësia e komunikimi i virtytshëm që përbëjnë dimensionin e tij njerëzor. Kryesia e OBVL i shpreh ngushëllime

Familjes Hajredinaj dhe të afërmëve për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Me respekt

ISUF IMERAJ

Anëtar i Kryesisë së OBVL-së

Koha për kompromis historik

(Vijon nga faqja 1)

njëri-tjetrit, si reflektim ndaj ndërgjegjësimit e pasqyrimit real të shqetësimit jetik të shoqërisë së sotme shqiptare, për t'iu larguar kimit e urrejtjes ndaj njëri-tjetrit. Është koha kur kërret aktualë të dy shteteve tona (Shqipëri dhe Kosovë) mund dhe duhet të ndikojnë për Pajtimin Kombëtar, në një kohë kur grindjet, shpifjet, sharjet, sherret e shernajat po kthehen në institucion, edhe mes tyre, në institucione publike e në debate televizive, si dhe brenda sallave të dy parlamenteve. Këtë domosdoshmëri e diktor, edhe përvoja e vendeve më të zhvilluara perëndimore të cilat në themel të zhvillimeve të vrullshme kanë patur dhe kanë bashkëpunimin mes palëve. Veçanërisht shembulli i Gjermanisë, nga e cila i kemi varur shpresat për çeljen e negociatave ia imponon klasës tonë politike kompromisin e shumëkërkuar i cili në themel duhet të ketë bashkëpunimi mes pozitës dhe opozitës për të përmbushur kërkesat e Bungedestagut gjerman, sidomos realizimin e reformës zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE/ODHIR.

Duke e vlerësuar këtë situatë në kontekstin historik, OBVL u bën thirrje kërreve aktualë të shtetit dhe të mazhorancës e opozitës që të ulen në tryezë për të arritur kompromisin historik aq të dosmoshëm që të konsistojë në unifikimin e qëndrimeve për të përmbushur detyrimet për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian. Për këtë vendimmarrje historike le t'iu referohen kuvendeve historike mbarëkombëtare, që nga Lidhja e Lezhës që i bashkoi shqiptarët rreth Heroit Kombëtar, Skënderbeut, Lidhja e Prizrenit që ndikoi në bashkimin e shqiptarëve për mbrojtjen e çështjes kombëtare, jo vetëm ndaj fqinjëve grabitqarë por edhe para Europës e deri tek Konferenca e Pezës që bashkoi shqiptarët pa dallim feje, krahe e ideje në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ashtu siç veteranët e LANÇ bënë atë Luftë të lavdishme, duke e bërë Shqipërinë pjesë të Aleancës së fuqishme Antifashiste të Popujve të drejtuar nga SHBA, Anglia e ish BS, është koha që edhe kretët e shtetit, të qeverisë e politikës shqiptare të realizojnë PAJTIMIN KOMBËTAR, i cili kurrësesi nuk mund të arrihet pa realizuar kërkesat e ndërkom-bëtarëve.

***Sekretar i Përgjithshëm i OBVL-së
*Nënkyetar i OBVL-së**

IN MEMORIAM

Dëshmorët që dha Lajthiza në Luftën e Dytë Botërore treguan se qendresa e burrave të kësaj kurore është vazhdimësi

MARK LLESHI – VETË I SHTATË, BASHKË ME TRIMAT LAJTHIZAKË

ZEF RROZHANI

• **Heroi i Popullit Dedë Gjon Luli (1840-1915), Dëshmorët e Atdheut të Lajthizës: Ndue Kola (1915-1915) – Mark Lleshi (1876-1915); Llesh Margjini (1874-1915); Preng Skana (1881-1915); Preng Deda (1890-1915); Zef N.Gjoka –Markaj (1896-1915); Bibë Markola-Vlashaj (1877-1915) janë nderi dhe krenaria e Mirditës, popullit dhe kombit shqiptar**

Kujtdo që kalon në rrugën e Kombit për në Morinë e anasjelltas, aty në krah të kësaj rruge kombëtare, në zemër të Mirditës, i shfaqet madhërisht një obelisk kushtuar Dëshmoreve të Lajthizës së Oroshit. Kjo vepër monumentale e sponsorizuar nga nipi i Dëshmorit të Atdheut Mark Lleshi, Preng Ndue Lleshi dhe nipit Nikoll Kola, njëkohësisht shkrimtar, autor i mbi shtatë librave me vlera të pallogaritshme është frymëzim për rininë e sotme dhe për brezat e ardhshëm.

Duhet thënë se shtatë Dëshmorët e ylberit të "Gurit të Kuq" qëndrojnë hijerëndë në panteonin e vlerave. Lajthiza nuk i harron. Ajo është "selia" e gardës së lirisë për Oroshin...

Lajthiza e dëshmoreve të luftës kundër serbëve, Lajthiza e dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare. Lajthiza e bukurive të njerëzve të natyrës. Lajthiza është si një stoli që i jep jetë atdheut me freskinë e saj. Lajthiza është Oroshi i bjeshtëve, që e para i thotë Korabit. "Leshoma diellin". Emri i saj vjen nga Lajthitë e shumta që dikur formonin një brez në prehër të maleve në lindje me bjeshtët e Oroshit.

Ka një histori tjetër më shumë Lajthiza. Të bukur, të gjatë, të fuqishëm dhe shumë njerëzor e bujarë; Lajthi-

zakët dallohen kudo. Pas njerezisë së tyre fshihet trimëria, besa dhe dituria. Ata kur nuk flasin për vehte, por lavdërojnë miqtë.

Ato ishin mjeshtra të vërtetë të punimeve me dru. Mjeshtrat e këtij vendi kanë zbuluar tavane e çardakë kullash në Dibër, Mat, Mirditë e Kukës. Dora mjeshtrorë e tyre ka prekur edhe Shkodrën...

Kur e ka dashur puna, ato kanë treguar edhe trimërinë e dinjitetin që mbartin.


Shtatë Lajthizakët e Luftës së Parë Botërore, kanë nderuar Kombin me heroizmin që bënë. Gjaku i tyre ngrin akull në atë shpellë të ftohtë për të shkrirë qindra e mijra zemra të shtangura para thikave të ushtarëve serb. Dëshmorët që dha Lajthiza në Luftën e Dytë Botërore treguan se qendresa e burrave të kësaj kurore është vazhdimësi.

Të flasësh e të shkruash për Lajthizën dhe njerëzit e saj duhen volume të tëra. Ato mbartin në vehte merita historike që i vulosën me heroizmin e gjakun e tyre.

Udha e jetës dhe vepra e shtatë Lajthizakeve na çon te madhështia që hesht...Shtatë trimëri që u therën nga barbarë, shtatë të vërteta që heshtin në prehër të harresës sonë. Shtatë të vërteta që i rivrasin duke dyshuar, shtatë Dëshmorët të Atdheut që të paktën meritojnë fjalën për atë që folën.

Kur ishin ato burra që thirrën qiellin në atë ftohtësi, që i shoqëroi një shekull, në atë heshtje të pamerituar.

Ja pra: Heroi i Popullit Dedë Gjon Luli (1840-1915), Dëshmorët e Atdheut të Lajthizës: Ndue Kola (1915-1915) – Mark Lleshi (1876-1915); Llesh Margjini (1874-1915); Preng Skana (1881-1915); Preng Deda (1890-1915); Zef N.Gjoka –Markaj (1896-1915); Bibë Markola-Vlashaj (1877-1915) janë



nderi dhe krenaria e Mirditës, popullit dhe kombit shqiptar.

Shtatë burrat e Lajthizës së Oroshit janë burrat e besës së Mirditës. Ato dhanë jetën me patriotin e madh, luftëtarin e paepur, plakun dhe mikun e maleve Dedë Gjon Lulin. Jeta e dhënë, gjaku i derdhur dhe qëllimi i shenjtë u bënë themel i bindjes popullore të asaj kohe, se miku nga Hoti, nuk u pre në besë. Në vazhdimësi e heroizmit Lajthiza i dha Atdheut bijte e saj që ranë për lirinë luftën Nacional çlirimtare Gjin Ndue Kola 1915-1945 dhe Ndue Gjon Kola 1921-1946, të cilët prehen në varrezat e Dëshmoreve në Tiranë. Por dëshmorët e Luftës së Parë Botërore nga Lajthizakët u trashëguan edhe në Luftën e Dytë Botërore.

Bijtë e Lleshajve, Skanajve, Deda-je, Margjinajve, Markolajve, Kolës e Çokut e trashëguan trimërinë, bujarinë e besën ndër breza, po ashtu edhe në ditët e sotme.

Ja pasardhësit e Dëshmorit të Atdheut Mark Lleshi – Frroku vëllai, Gjoni i biri Gjergji, Gjini, Frroku – Prenga, Gjoni dhe Prenga trashëgimtar i denjë shembëlltore e dashurisë dhe bamirësisë. Njeriu që megjithëse jeton në breg të detit Adriatik. Endrrat i sheh aty në

Lajthizën e tij të dashur aty ku lindi dhe u rrit, aty ku u fladit me ajrin e pastër e sot u flet me vepra djemve të tij, u kujton varret e të parëve të tij. Ai Obelisk, një përmendore e përjetshme nuk flet vetëm për gjyshin e tij por shumë e shumë se çdo kapital i vendosur ai me mund e djersë.

Po kështu edhe miku im Avokat Nikoll Kola, nipi i Dëshmorit Ndue Kola së bashku me kushërinjtë e tij, jo pak por një dyzinë su gurë të çmuar të jetës njerëzore duke rrezatuar kudo mirësi e bujari, duke bërë të pavdekshme veprën e të parëve të tyre.

Ndaj ato shtatë Dëshmore të Atdheut, prehen në paqe në varrezat e Dëshmoreve në qytetin e Rrëshenit.

HOMAZH

“Qytetar Nderi” në qytetin Heren të Belgjikës në vitin 1997-të, për mbrojtjen e jetës së dy shtetasve belg që ndodheshin në Shqipëri në atë kohë

KOLONEL QAZIM BAJRAM DUTAJ, MODELIMË I MIRË I USHTARAKUT TË USHTRISË SHQIPTARE

ALI DEMUSHI

Kryetar i OBVL-dega Shkodër

Me 04 Shkurt 2020 familja, të afërmit, shokët dhe kolegët, miqtë dhe dashamirët e shumë nga qyteti i Shkodrës i dhanë lamtumirën ish kuadrat të lartë të Ushtrisë Shqiptare, Kolonelit në pension Qazim Dautaj.

Qazimi lindi me 10 Janar 1933 në fshatin Ahmataj të Tropojës (Malësisë së Gjakovës) në një familje me tradita atdhetare dhe patriotike që ishte rreshtuar me djemt e burrat e malësisë sa herë e kërkonin interesat e mbrojtjes së trojeve amtare, në luftë me armiqtë e shumë të nga ata osmanllinj, serbo-sllav, çetniko-malazezë e nazi-fashist, ku në Luftën Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar vëllai i tij Ibrahim Dautaj dha jetën duke luftuar kundër armikut, i cili tashmë është shpallur Dëshmor i Atdheut.

Qazimi mbasi mbaroi shkollën fillore edhe atë 7 vjeçare në vendlindje në vitin 1947, vazhdoi e përfundoi studimet në shkollën Teknike Bujqësore në Kavajë me rezultate shumë të mira në vitin 1950. Mbas përfundimit të kësaj shkolle u emërua dhe kreu për dy vjet 1950-1952, detyrën e nën drejtorit të Kooperativave të Bashkuara në rrethin e Tropojës. Puna në këtë sektor të ekonomisë e aftësoj si kuadër por një herësh i lindi dëshira për të vazhduar studimet në fushën ushtarake, i nxitur edhe nga disa kuadro të kësaj fushe, bashkëvendas të tij.

Kështu ai studioi dhe përfundoi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në vitin 1952-1954, në armën e këmbësorisë. U titullua oficer me gradën N/Toger dhe u emërua në Divizionin e Shkodrës në detyrën e komandantit të togës së zbulimit për divizionin. Duke punuar me përkushtim dhe devotshmëri dhe i vlerësuar nga komanda eprore dërgohet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve për tu specializuar në armën e Artilerisë Tokësore nga viti 1957-1959. Aty mori gradën e kapitenit dhe në përfundim u riemërua në Korposin Ushtarak të Shkodrës të asaj kohe.

Qazim Dautaj që nga viti 1959 e deri sa doli në pension (rezervë) në vitin 1988 shërbeu në ish Divizionin (Korpusin) e Shkodrës në detyra të niveleve të ndryshme në armën Artileri Tokësore, si në atë të nivelit të specialitetit, të oficerit të shtabit të repartit e njësisë deri në Korpus si dhe të nivelit komandues e drejtues në njësi (Brigadën e Artilerisë Tokësore) që i përgjigjej gradës kolonel.

Qazimi studioi e përfundoi edhe Akademinë Ushtarake të Mbrojtjes-Tiranë 1968-1970 ku u kom-



pletua me dije më të plota shkencore mbi Artin Ushtarak dhe mbrojtjen në tërësi, të nivelit Operativo – Strategjik, të cilat i shërbyen më së miri për të realizuar me sukses planifikimin e zbatimin e detyrave të stërvitjes e të gadishmërisë luftarake të njësisë që komandonte e drejtonte.

Specializimi që kishte bërë për topo-geodezi ia mundësoi kryerjen e detyrës së shefit topograf të Artilerisë Tokësore të Korpusit në vite 70-të. Kështu ai ishte i kompletuar me njohuri të mjaftueshme në fushën ushtarake dhe kudo në repartet dhe njesitë e Korpusit të Shkodrës ndihej nevoja e dorës së tij në planizimin e detyrave të zjarrit të Artilerisë Tokësore në të gjithë brezin e mbrojtjes që nga fronti në thellësi e në prapavija të kundërshtarit (armikut). Gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake mëse 35 vjeçare, Qazimi

shërbeu me devotshmëri duke kryer me ndër të gjitha detyrat që ju ngarkuan. Ai vërtet në vitet e fundit të karrierës ushtarake kreu detyrën e Komisarit të Brigadës së Artilerisë Tokësore, por realisht ai ishte komandant më shumë sesa komisar e kjo shihej qartë tek aftësitë dhe ecuria në karrierën e tij.

Qazim Dautaj ishte i pajisur dhe i brumosur me cilësitë më të larta dhe më të pastra morale e njerëzore. Ishte i dashur dhe i respektuar me shokët, kolegët, eprorët dhe vartësit e tij, ishte masovik në kuptimin e lidhjeve me efektivat ku punoi si dhe në bashkëpunimin e ngushtë me komunitetn vendas Shkodran, ku shtrihej e vepronte njësisia e tij ushtarake, në interes së kryerjes së detyrave për mbrojtjen e Atdheut, ndaj kudo flitej më shumë respekt për personin e Tij.

Pas daljes në pension (rezervë)

Qazimi kontribuoi në Organizatën e Ushtarakëve në Rezervë e në Pension, për ruajtjen e dinjitetit të ushtarakut dhe transmetimin tek brezat e rinj të vetive dhe virtyteve më të mira të ushtarakut.

Ai proceset demokratike në vend dhe reformat në ushtri i priti dhe i mbështeti me kënaqësi, por gjëndjen që u krijua në ushtri në vitin 1997 e përjetoi me dhimbje por pa e humbur shpresën se ajo (ushtria) do e merrte veten duke u përfshirë në Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO).

Qazimi njëherësh ishte edhe familjar shembullor. Ai me bashkëshorten e tij Talen, lindën, rritën, shkolluan dhe edukuan gjashtë fëmijë që janë për tu marrë shembull pozitiv, prej tyre një djal Besnikun dhe pesë vajza, Vjollcën, Valbonën, Mimosën, Lilin dhe Irmën. Aq shumë e deshti jetën ushtarake Qazimi sa që djalin e tij Besnikun e dërgoi në shkollë për oficer e ky për aq kohë sa shërbeu në detyrën e komandantit të baterisë kundra ajrore, qe një nga kuadrat e rinj shembullor.

Për punën e tij në Forcat e Armatosura Qazimi është vlerësuar duke u dekoruar me Urdhëra e Medalje të ndryshme nga autoritetet e larta shtetërore.

Ai është shpallur “Qytetar Nderi” në qytetin Heren të Belgjikës në vitin 1997-të, për mbrojtjen e jetës së dy shtetasve belg që ndodheshin në Shqipëri në atë kohë.

Shoqata “Malësia” e rrethit Malësi e Madhe “Nderi Kombit” e ka nderuar me Çertifikatë Mirnjohje mbas vdekjeje për kontributin e dhënë në fushën e mbrojtjes në atë rreth kufitar ndër vite.

Me rastin e ndarjes nga jeta të Kolonelit Qazim Dautaj, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, i bëri telegram ngushëllimi familjes në emrin e Tij personal dhe të gjithë personelit të Forcave të Armatosura, me 4 Shkurt 2020, duke vlerësuar punën dhe veprën e Qazimit, që ishte dhe do të mbetet shembulli dhe modeli më i mirë i ushtarakut të Ushtrisë Shqiptare.

Shoqata “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë” (AKUSH), dega Shkodër dhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL)-dega Shkodër në bashkëpunim me repartin ushtarak të Vau Dejës, organizuan ceremoninë mortore për të ndjerin Kolonel Qazim Dautaj, duke i shprehur ngushëllime familjes së Tij, të afërmeve, shokëve, kolegëve e dashamiresve, me premtimin se Qazimi do të kujtohet përherë në aktivitetet e tyre.

I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij

7 MARS

I kualifikuar si mësues i kategorisë së parë, kontribuon për mësimin dhe edukimin e mësuesve

35 vitet e mësuesit fisnik Adem Kadri Laçi

Xhemal Meçi - "Mjeshtër i Madh"

Tridhjetepesë vite në arsim, janë vërtet një kontribut i çmuar i mësuesit Adem Kadri Laçi. Ai emërohet mësues më 1953 emërohet sapo përfundon me rezultate të mira shkollën "unike" 7-vjeçare, se ishte koha kur duheshin sa më shumë mësues për ta përbërur hapjen e shkollave në tërë vendin;

Në vitet 1953 - '57 shërben mësues në shkollën fillore Rrape, ku arrin rezultate të mira mësimore; Ndërsa në harkun kohor 1958 - 1960 përfundon shkollën e mesme pedagogjike 2-vjeçare në Elbasan. Edhe pse arriti rezultate të mira në shkollat ku e caktonin, prapë nuk e lenin të merrte frymë, por nga shkolla në shkollë (12 emërime, njëri pas tjetrit) për ta detyruar, që të refuzonte.

Ishte koha kur diktatura komuniste (gjoja diktatura e "klasës punëtore", që mbahej në këmbë me "Luftën e Klasave" Dhe se Adem Laçi kishte gjoja probleme politike në biografi: i vëllai i gruas, i Kajdës, Hasan Ismajl Pema që i dënuar politik në ushtri, në ishullin Sazan i Vlorës gjoja për thyrje disipline dhe lidhjet që paska pasë me Kazazët e Shkodrës, duke vuajtur 18 muaj burg politik; gjithashtu kishin pushkatuar vëllezërit Isuf Avdi Laçi (1946) dhe kapitenin ushtarak Qazim Avdi Laçi (1952), për atentatin në Ambasadën Sovjetike, sado që Ademi nuk kishte asnjë lidhje gjaku me ta, veç mbiemrit e me banim në një lagje; por partiakët ngulmonin e gulçonin se edhe kushëriri i tij kolonel Xhemal Laçi kishte qenë ministër i Oborrit Mbretor të Mbretit Leka Zogut



në Madrid, mandej i arratisur politik në Amerikë (USA). Po kështu ish-kapiteni rezervë i xhandarmërisë së Zogut, Ymer Bardhosh Laçi, i cili që edhe komandant i çetës partizane Pukë-Has (1941-1944) në vitet 1960 i burgosur politik. Tani Ademi duhej të tregojë i kujdesshëm për të argumentuar se dhe pse i kishte kushërinj (Xhemal Laçin e Ymer Bardhosh Laçin) i kishte më se 4 brezë larg, kur dihej se "kriteret politike" të Komitetit Qendror (PPSH) nuk shkonin më shumë se 2-3 brezë. Megjithatë manjakët partiakë nuk pushonin duke gjurmuar e numëruar brez pas brezi sa u donte egoja e tyre me "armën" e "Luftës së Klasave" se si me përkulë Adem Laçin.



Ademi ishte rritur jetim nga baba, që e kishte lënë si edhe motrën të mitur. E ëma, Raba, grua burrëshë rriti fëmijët me ndihmën e kujdesin e kunatit bujar e i pakursyer, Musë Halil Laçi. Ademin, si djalin e vetëm të Kadri Laçit e shikonin në dritën e syrit, duke e edukuar me dashurinë për punën, profesionin dhe i bindur e i mirëkuptuar në komunitet. Kështu kudo, ku emërohej përpiquej të kishte paraqitje të bukura të figurës së mësuesit dhe të punonte me përkushtim e dashuri për nxënësit, duke iu shpëtuar me durim e gjakftohtësi përndjekjeve partiake. Kur e pyeta aty nga viti 2005 pensionistin nga fshati Rrypë bletërritësin Ismail Sadria, se sa shkrim të bukur kishte, m'u përgjegj se mësuesi i tyre i viteve 1950, "Adem Laçi, mësues zotni e i duruar, i jepte rëndësi bukurshkrimit edhe në diktimit e detyra me shkrim, prandaj na u bë edukatë të shkruanim bukur tërë jetën."

Duke pasur suksese në çdo shkollë ku e emëronin deri në masën e mësuesit shembullor, arriti të vazhdonte me sukses mësuesinë. Për më tepër u pa e nevojshme, që për nevoja kuadri të ngrihej nga fillorja në klasat e tetëvjeçarës, klasa VI - VIII. Edhe aty shkëlqeu me këndet sportive model dhe kabinetin e historisë dhe të gjeografisë në shkollën 8-vjeçare të Kabashit. Por që të vlerësohesh qoftë edhe me gjysmë zëri, u desh të vinte për kontroll ekipi i ministrisë së Arsimit me zv/ministrin Bedri Dedja, profesori i nderuar akademik, i cili e përdori shembullin e Adem Laçit si model pune kabinet-klasë, që duhej ndjekur edhe në shkollat e tjera 8-vjeçare të Pukës. Kjo arritje e tia u shpreh edhe në gazetën "MËSUESI", në kuadrin e 50-VJETORIT të Shkollës Kabash (1918-1968), sado thjeshtë e përciptazi, por shërbeu për mirë, sepse Adem Laçi, megjithë përshpëritjet e partiakëve mediokër e ndjellkeq, me propozim të Seksionit të Arsimit (me shef Ramadan Hoxha, "Mësues i Merituar" dhe zv/shef Ndue Jak Pjetri, "Mësues i Popullit") mësues Ademi u caktua drejtor i Shkollës 8-vjeçare Kabash, e cila tani u kthye në qendër me rëndësi metodike për mësim shembullor, ku mësuesit e shkollave të rrethinës fitonin përvojë për proceset mësimore - edukative. Nga mesi i viteve 1970 në shkollën e

Kabashit dërgohen për stazh në bazë dy prej kuadrove më të mirënjohur të arsimit të Rrethit Pukë: Ndue Jak Pjetri dhe Ramadan Hoxha në shkollën e Kabashit me drejtor shkollë Adem Laçi. Tani Shkolla e Kabashit u radhit ndër më të mirat të Rrethit.

Po mësues Ademi sado me përkushtim, ishte edhe familjar i kujdesshëm. Të shtatë fëmijët e tij (4 djem e tri vajza) i rriti dhe i edukoi që të jenë punëtorë dhe të papërtuar edhe pse nuk u dhanë "të drejta studimi" në shkolla profesionale. U desh të vinin vitet e tranzicionit demokratik, që Ademi të mund të merrte prej shoqatës së të përndjekurve politik një bursë për një prej 7 fëmijëve, vetëm për Saimirën për arsim të lartë në mjekësi, që e përfundoi me sukses dhe filloi shërbimin mjekësor në spitalin e Pukës, ku pacientët e prind filluan ta thërrisnin me respekt: "doktoreshë Saimira!", që dukej si një ngushllim i magjishëm për familjen e ADEM LAÇIT, kur 6 fëmijët e tjerë nuk e gëzuan një "të drejtë" të tillë studimi, edhe pse babai i tyre ishte mësues i dalluar e drejtor shkollë edhe sado që kishte përgatitë aq nxënës në shkollat, ku jepte mësim. Por ishte një "karakteristikë" organizate -bazë Partie, e përbërë në të shumtën e herës prej anëtarësh me katër klasë fillore, por edhe smirëzinj, që të godiste pa të drejtë te e ardhmja e fëmijëve. -Edhe kur donim ta përkrahim ndonjërin si mësues Ademin, na sillnin mbi tavolinë një karakteristik "sterrë" të organizatës - bazë të Partisë (PPSH), që na mbyllte gojën para zyrës (ogurzezë) të kuadrit, - shprehej në konfidencë Ramadan Hoxha, Shefi i seksionit të arsimit të rrethit Pukë.

-Ti e di se si u bë nami në komitet të Partisë (PPSH) dhe Komitet Ekzekutiv të rrethit Pukë, kur arritëm të dekoronim ty Xhemal dhe Qamil Pemën me dekoratën e thjeshtë "NAIM FRASHËRI", edhe pse meritoni më shumë si arsimtarë të dalluar në krejt rrethin tonë. Po ç'të bënim! -e mbyllte fjalën me aq Ramadan Hoxha, shumë njerëzor dhe shok i ngusht i imi. Në këto rrethana përplitej edhe mësues Ademi, por gjithëmonë në dukje i qetë e buzëqeshur, por duke e mbyllur thellë në zemër mospranimin për të drejta studimi për fëmijët, qoftë edhe

për profesione të thjeshta.(!)

Edhe si doli në pension i duket se e prisnin nxënësit e fshatit Rrape, Dedaj, Gomsiqe, Bushat, Luf, Qelëz, Lajthizë, Llukë, Blinisht, Kabash, (në të gjitha këta 15 emërime shkollash në 35 vite), gjithnjë larg shtëpisë. E në këto 35 vitet rrugë më këmbë në dimër e verë, në shi e borë.

-Mësues Ademi, prit pak, dua të të pyes diçka. Ai ndalet, ashtu i buzëqeshur si gjithnjë dhe e fton edhe për një kafe, një ish-nxënës i tij nga Rrapja, ndonëse nuk e dëshironte qëndrimin kafeneve, kësaj here sikur e ndjeu të detyrueshme për respekt të ish-nxënësit të tij, që e kujton pas aq shumë vitesh.

-Po ta pyesje shoqërisht për jetën e tij si arsimtar, ai nuk vononte të shpalosë nga kujtesa vitet e para, kur pas mbarimit të shkollës së vendlindjes, në Pukë dhe të përfundimit të studimeve pedagogjike në Elbasan; sidomos e kujtonte me emocione ditën kur pat dalë për herë të parë para nxënësve si mësues dhe edukator i tyre. Ishte viti 1953 kur i komunikohet vendimi i fillimit të punës si mësues në Rrape. Për katër vjet mësues Ademi qëndron në këtë shkollë. Ndoshta do të ishte shkolla më e afërt, mbasi emërimet e mëvonshme do të ishin më larg qytetit të Pukës. -Ecja mëngjesëve dhe pasdrekeve 4-5 orë në këmbë dhe ashtu nuk e ndieja lodhjen. se isha në një detyrë fisnike; edhe rrugës kisha parasysh nxënësit, punën time përgatitore për ditarin e së nesërme, -shprehej me një kënaqësi të veçantë Adem Laçi.

Kështu kaluan vitet, i emëruar 15 herë në shkolla të ndryshme. I kualifikuar si mësues i kategorisë së parë, kontribuon për mësimin dhe edukimin e mësuesve. Në dosje i gjen vetëm vlerësime për mirë të punës së tij. -Asnjë ditë mësimi, -thotë, - nuk jam paraqitur pa ditari. Këtë e bëja jo sa për të thënë se kam ditarin, por aty kisha punën time të ditës si mësues. Vlerësohet për vepërimtarinë shkencore-pedagogjike. Në shumë seminare referon nga përvoja e tij tema të ndryshme. Në klasat ku ka dhënë mësim, disa herë janë zhvilluar mësimet treguese. Në shkollën 8-vjeçare Kabash i vlerësohet puna për kabinetin e histori-gjeografisë, një ndër kabinetet më të pasura në vitin 1971 nga ish-zëvendësministri i arsimit, akademiku prof. Bedri Dedja. Si një mësues metodist, ndër më të dalluarit e shkollave të rrethit, do ta cilësonte gazeta "Mësuesi" në një shkrim të botuar me rastin e 50-vjetorit të shkollës së Kabashit.

E veçantë e punës së tij: korrektesa me detyrën, vullneti për punën, mundimi i përditshëm për të gjetur metoda të reja bashkëkohore për mësimin e nxënësve. Gjithnjë i sjellshëm me kolegët, nxënësit e prindërit e tyre. Por, përsëri u deshtë të vinte Nëntori i vitit 1992 që të dekorohet me medaljen "NAIM FRASHËRI". E ruan këtë dekoratë, -siç thotë, se më duket se përmes saj sikur hap kasetën për të parë rrugën e 35 viteve të jetës sime të vështirë në arsim. Kurse "Doktoreshë Saimira tani në pleqërinë e tij prej pensionisti, ishte një ngushëllim pas aq shumë shqetësimesh të "Luftës së Klasave", por që mësues Ademi, e përballoi me aq sukses. Shembulli i mësues Ademit nuk ishte i vetëm në Pukë e në mjaft rrethe të tjerë të Shqipërisë në vitet e Diktaturës moniste komuniste.

LETRAT

Cikël me poezi, nga vëllimi “Bëhu mik me diellin”

Nga Liljana Muça

Vizion gruaje ...

PËR NËNËN

Ka mbetur fjalë mjalti pa thënë për ty
A nuk je ti det i gjërë që fal dashuri?
Dashurisë tënde i falim prap dashuri
Rininë tënde, jo s'e lëmë të vdesë
I japim nga shpirti, mishi e gjaku ynë
E kësisoj ti nënë, kurrë nuk vdes.

SHTIGJET E GRUAS

Grua,
mos humb në shtegun e humbur
të skllavërisë
Kalo në shtegun e artë të yjeve
për të qënë Përmendore e Lirisë.

Faqen mos ja kthe shuplakës
së marrëzisë
Kapërceje shtegun e krisur të xhelozisë
Për të qënë me të vërtetë
Përmendore e Lirisë.

NUK I FALË DASHURI...

Një vilë e ngrite si në përralla
Dhe veten mbret e vure,
mbret pa andralla
Zgjidhe për mbretëreshë
Një vajzë të bukur si zana
Me florinj e mbulove
Çuditërisht me pranga!
Mendove se i fale pasuri pa kufi
Po çfarë vlere kishin ato
Kur nuk i fale kurrë dashuri?!

TË PRES

Të pres kur të agojë dita
Merri agimit veshje të trëndafilta
Të pres kur të vesojë vesa
Merri tërfilit veshje të gjelbërta


Të pres kur të bjerë perëndimi
Merri mbrëmjes çaste ngazëllimi
Të pres kur të dalin yjet
Merri natës freski nga pyjet.

GRUAS

Gruas mos ia mat lirinë te pragu
Gruas mos i thuaj je qoftëlargu
Për të qënë në shpirt, i qetë së paku.

VDEKJA E DASHURISË

Sa herë ti harron të jetosh
Dashuria vdes.



Sa herë ti harron të kuptosh
Përsëri dashuria vdes
Sa herë nga vetja ti mund të dalesh
Dashuria vdes
Sa herë kur ti s'mund të falësh
Dashuria vdes.

DASHURIA S'ËSHTË PRONË

Më fluturon vetmitar
Shpirti përgjysëm,
shpirti i ndarë
U deshëm sa shumë
pa anë,
por ti ngrite piramida
me fjalë
për t'i ngulur së kufij marrëzie.

Ç'poshtërsi,
perlë hipokrizie!
Dashuria s'është pronë
për ndryshe s'do quhej dashuri
pa frymëmarrjen tënde, LIRI.

PASHË

Pashë një njeri, burrë
Që tërhiqte zvarrë një grua
Pashë një burrë,
që s'kishte burrëri
Pashë një njeri, grua
Që rezistonte me një burrë
Pashë një grua,

burrëreshë grua.
Pashë një njeri
Sa çudi!!
Njeri, që nuk ishte njeri.

TRILLE

M'u vyshkën edhe trëndafilat
sa e sa orë duke të pritur
Se ti ngahera bën ca gjëra...
për të t'quajtur si të lajthitur.

M'u vyshkën edhe trëndafilat
Kot që s'ia dhashë një vajze tjetër
Se ti ngahera bën ca gjëra...
Që nuk i hedh dot as në letër.

FYTYRA E DASHURISË

Dielli u dashurua me detin
Me një puthje të zjarrtë
U mbyt në të.

Hëna u dashurua me mëngjesin
me një puthje të pafajshme
u tret në të.

Ajo u dashurua me dikë
Në një pritje të gjatë
U mplak pa të.

KUR BIE MBRËMJA

Shelgjishtet buzë lumit kanë varur degët
Dhe fladi valët ngre e barin tund
E mrekulluar pas kësaj bukurie
Nuk mund të rri e heshtur, nuk mund.

Ç'e bukur kjo mbrëmje, si një vajzë e bukur
Jehonën përcjellin grykat dhe lumi zhurmon
Shtrin krahët mbrëmja, mbi kodra bie muzgu
Pa shpirti më ndizet dhe zdi ku shkon.

ZGJIM

Mëngjesi me vesë zbriti i pikëlluar
Dita me përtesë sikur u zgjua.

Dielli shigjetoi nga maja e malit
Vajzës iu zgjua ëndrra e mallit.



DITELINDJA

SHPENDI TOPOLLAJ

FESTON DITËLINDJEN E 73-të

KADRI TARELLI

ME LIBRA TË RINJ

Shpendi Topollaj më 14 shkurt 2020, në ditën e shenjtë të "Shën Valentinit", festoi ditëlindjen e 73-të. Për të si njeri, poet, tregimtar, novelist, romancier, publicist e kritik letrar, mund të flasësh gjatë, pasi ke se ç'të thuash si për veprën e tij shumëdimensionale, plot talent e kulturë të jashtëzakonshme, ashtu edhe për vlerat e spikatura njerëzore e atdhetare që si rrallëkush ka.

Me karakterin e pathyer të ish oficerit, me sensin e drejtësisë si jurist, por dhe me shpirtin e bukur e të ndjeshëm poetik, ai gëzon dashurinë dhe respektin jo vetëm të të gjithë qytetarëve durrsakë, por edhe të kujtdo që e njohu apo lexoi nga krijimtaria e tij. Dhe ja, ku vjen tani me librin e porsa botuar studimor nga Shtëpia botuese "2Mprinting", "Dantja... e të tjerë", ku ka përzgjedhur korifejtë e letrave ndër shekuj (...Petrrarka, Bokaçio, Shekspiri, Hygoi, Pushkini, Tolstoi, Esenini, Cvajgu, Eminesku, Shollohovi), përfshi shkrimtarët tanë Fishta, Lasgushi, Kadareja e Dritëro Agolli.

Është një libër serioz, me gjykime të thella dhe plot kureshtje, i shkruar me aq kompetencë dhe dashuri, i cili i bën nder jo vetëm këtij autori, por edhe vetë letërsisë shqipe. Kush do ketë rastin ta lexojë do të më japë plotësisht të drejtë, ashtu sikurse ngjau edhe me librin tjetër të tij "Ese rreth shprehjeve mitologjike", që është pritur aq ngrohtësisht.

Po e uroj me gjithë shpirt këtë autor që përherë i feston ditëlindjet me një tufë librash të rinj, me një poezi

timen, pavarësisht se për të janë shkruar volume të tëra

JETA DHE VEPRA E SHPENDI HULËSI TOPOLLAJ

Është lindur më 14 shkurt të vitit 1947 në Berat. Babaj i tij Hulësiu, partizan nga të parët, e më pas oficer, jurist dhe shkrimtar, ishte nga Novosela e Kolonjës, kurse e ëma Hatijeja, ishte nga fisi i dëgjuar për atdhetari i Agallinjve në Vlorë. Fëmijërinë dhe rininë e ka kaluar në Shkodër dhe Tiranë. Sot, punon e banon në Durrës prej më se pesëdhjetë vjetësh. Me të përfunduar shkollën shtatëvjeçare "Misto Mame", nis studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", të cilën e mbaron në vitin 1964. Më tej vazhdon shkollën e Bashkuar të Oficerëve, dhe në vitin 1966 titullohet oficer këmbësorie. Emërohet në repartet e Durrësit, ku kryen detyra të ndryshme, si instruktor i stërvitjes me universitarët, shef i stërvitjes së Brigadës së Katërt të Mbrojtjes Bregdetare, komandant batalioni. Por duke qënë se i ati i tij goditet rëndë, si bashkëpunëtor i "grupit puçist", me argumentin se kishte shkruar dhjetë vjet më parë një libër për luftën Nacionalçlirimtare, ku lartësonte figurën e Heroit të Popullit, Petrit Dume dhe të drejtuesve të tjerë të kësaj lufte në Kolonjë, ndëshkohet me pretekstin se ka lexuar një libër me kritika letrare të prof. dr. Rexhep Qosjes dhe pas një sërë masash, çohet me një detyrë të ulët, në një repart të largët, ku qëndron i harruar për rreth njëzet vjet. Me formimin i tij intelektual, edukatën e marrë në familje dhe përkushtimin në detyrë, ai dallohet për rezultate shumë të larta. Të gjithë që e njohën apo punuan me të, e kujtojnë si një kuadër të talentuar, të kulturuar, të guximshëm, të ndershëm dhe me shpirt krijues që e donte ushtrinë me gjithë zemër. Ai gëzonte respektin e veçantë të shokëve dhe vartësve të tij,



oficerë dhe ushtarë.

Ndërkohë, kryen studimet në Universitetin shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e shkencave Politike - Juridike dhe studion me pasion, jo vetëm artin ushtarak, por edhe në fushën e letërsisë, artit, historisë etj.

Me gjithë vështirësitë e njohura, ai është nga të parët kuadro të ushtrisë që mbështeti me entuziazëm proceset demokratike në vend, duke predikuar gjithmonë mirëkuptim mes vëllezërve të një gjaku.

Duke parë aftësitë e spikatura të tij, pas përmbysjes së diktaturës, i jepet grada nënkolonel dhe emërohet shef i Mbrojtjes Civile të rrethit të Durrësit. Pas largimit nga ushtria, caktohet në detyrën e Shefit të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore në Këshillin e Rrethit. Bëhet promotor i organizimit dhe zhvillimit të dhjetra e dhjetra veprimtarive, kushtuar figurave të shquara, të goditura dhe lënë qëllimisht në hije apo të promovimit të krijimtarisë letrare të autorëve të ndryshëm, sidomos durrsakë. Puna e tij në këtë drejtim është krahasuar me atë të një institucioni të tërë. Këto veprimtari kanë qënë përherë mbresëlënëse dhe janë pasqyruar gjërësisht në të gjitha stacionet televizive, në radio apo gazeta të ndryshme.

Mbas suprimimit të seksionit që drejtonte, duke qënë jurist, fillon punë në Gjykatën e Rrethit, ku qëndron për shtatë vjet dhe prej dymbëdhjetë vjetësh, kryen detyrën e Përmbartuesit gjyqësor, gjersa doli në pension.

Nuk ka rreshtur së kryeri dhe detyrat shoqërore, si anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, nënkryetar i Shoqatës kombëtare "Skënderbegasi", kryetar i degës së kësaj shoqate në Durrës, anëtar i Kryesisë së shoqatës të miqë-

sisë Shqipëri - Rusi, nënkryetar i degës së SHKUR - it, sekretar i shoqatës së Intelektualëve në Durrës, kryetar i Bordit drejtues të teatrit "A. Moisiu", anëtar i Këshillit Kombëtar të OBLV-s dhe është zgjedhur Ambasador i Paqes. Pas viteve nëntëdhjetë, fillon të shkruajë dhe botojë krijimtari të mirëfilltë letrare, thuajse të gjitha zhanreve të letërsisë, si poezi, tregime, novela, romane, publicistikë, kritikë letrare etj. dhe qindra e qindra artikuj të shkruar e botuar nga ai, në shtypin e kohës, gjë që e bën të njohur kudo.

Shumë nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, janë botuar jashtë shtetit dhe janë vlerësuar shumë nga kritika e specializuar dhe lexuesit. Në Nëntor të vitit 2015 nga ana e Lidhjes dhe Shkrimtarëve dhe Artistëve të Rusisë i është akorduar çmimi "Pushkin" me motivacionin "Për bukurinë e fjalës dhe të mendimit". Për të dhe krijimtarinë e tij, janë botuar librat voluminozë "Të shkruash në liri - Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu", dhe "Liria e të shkruarit".

Ai është vlerësuar shumë lart për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga penat tona më të njohura. Në një nga librat e fundit, "Ishte koha kur...", kritiku Kostaq Xoxa duke folur për të shkruan: "Autori i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pasdiktaturës, Shpendi Topollaj, të befason me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezitë, në tregimet, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin, e thesareve të lashtësisë dhe veçanërisht të mitologjisë greke; në reportazhin artistik, në pasqyrimin dhe portretizimin e figurave të nëpërkëmbura nga një sistem totalitar gjysmëshekullor..."

Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

